



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Datë ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 12 , Datë 10 / 01 / 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 147 Regj, datë 10.11.2017, e z.M. R kundër Spitalit Rajonal Korçë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të racës dhe të gjendjes ekonomike.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹

K O N S T A T O I :

Në ankesën e sjellë pranë KMD-së, subjekti ankuesparashtron problematikën si më poshtë:

“Djali im D. R² është aksidentuar në muajin Qershor të vitit 2017 duke pësuar frakturë në pjesën e këmbës. E kam çuar tek doktori, z.V. K në Siptalin Rajonal të Korçës, i cili e ka kuruar për rreth dy muaj. Ai i ka bërë një ndërhyrje kirurgjikale të gabuar, nga e cila djali im mbeti i paralizuar. Më pas ky doktor më dërgoi tek Spitali i Traumës në Tiranë, sepse më tha nuk kam çfarë t’i bëj më djalit. Më pas e kam publikuar rastin tim tek emisioni “Stop”, pasi nuk po gjeja zgjidhje për problemin shëndetësor të djalit dhe falë ndërhyrjes së këtij emisioni djali filloi rehabilitimin pranë një klinike private. Ndaj doktorit që bëri ndërhyrjen kirurgjikale nuk është marrë asnjë masë disiplinore”.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

² Shtetasi D.R është nën 18 vjeç (datëlindja 15.12.1999) dhe përfaqësohet përpara Komisionerit nga i ati.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri, të marrë masë disiplinore ndaj mjekut V. K si dhe të dëmshpërblehet për dëmin që i është shkaktuar djalit të tij.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua:

Së pari, lidhur me pretendimin e subjektit ankues për paaftësi profesionale dhe mjekim të pakujdesshëm të mjekut V. K, ndaj djalit të tij, Komisioneri theksonse ai nuk është organi kompetent për të vlerësuar profesionalizmin e mjekëve. (përfshirë dhe rastin e mjekut V.K)

Urdhri Mjekëve të Shqipërisë është një Ent Publik, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.

Statuti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë është i bazuar në Ligjin Nr. 123/2014, datë 25.09.2014 “Për Urdhritin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, Ligjin Nr. 10106, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjin 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë".

Në nenin 4, të tij, parashikohet se: “Misioni i Urdhrit të Mjekëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të mjekut”.

Për rastet kur paraqiten ankesa për mjekët (rast pas rasti), Statuti i Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë, në nenin 34 të tij, parashikon se: “ 1.Pranë Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonalë funksionojnë Komisionet Disiplinore, përkatësisht Komisioni Disiplinor Kombëtar dhe Komisioni Disiplinor Rajonal. 2. Komisionet Disiplinore janë organizma të gjykimit disiplinor profesional të pavarur. Ato verifikojnë dhe shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat që vijnë nga çdo person apo institucion në Urdhërin e Mjekëve për shkelje të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, për kequshtrim profesioni dhe gabime mjekësore”.

Neni 35 i UMSH –së ka të përcaktuara kompetencat ndëshkimore , masat disiplinore për kequshtrim profesioni apo gabimet mjekësore.

“... Komisioni Disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Kur vërtetohet së anëtari ka kryer shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë

Mjekësore, Ligjit dhe akteve të tjera kodifikuese lidhur me ushtrimin e profesionit, e shpall atë fajtor dhe i jep këto masat përkatëse sipas parashikimit të këtij Urdhëri³:

Bazuar në këto parashikime ligjore, subjekti ankues duhet të paraqesë ankesë me shkrim pranë Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, i cili është organi kompetent për t'u shprehur për anën profesionale të mjekëve në përgjithësi, pra, dhe të mjekut V. K, për të dalë në konkluzionin nëse qëndron pretendimi ankuesit për kurim të pa kujdesshëm dhe jo profesional të djalit të tij nga ana e mjekut. Në varësi të konkluzioneve tënxjerra pas shqyrtimit dhe hetimit të fakteve, Komisioni vendos ose jo për masat disiplinore ndaj mjekut.

Pra, sa mësipër, theksojmë faktin se **Komisioneri nuk është institucioni kompetent për vlerësimin dhe gjykimin e anës profesionale të mjekut V. K.** Referuar nenit 21, pika 1 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Së dyti, lidhur me pretendimin për dëmshpërblim, që mund të ketë ardhur si pasojë e mjekimit të pakujdesshëm të mjekut V. K, **Komisioneri nuk ka kompetencë të dëmshpërblejë individët, por dëmshpërblimi mund të kërkohet gjyqësisht.** Lidhur me përfaqësimin Tuaj në gjykatë, për kërkimin e dëmshpërblimit, Komisioneri ju informon se, Ligji nr.10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, ka përcaktuar një organ shtetëror kolegjal, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, detyra kryesore e të cilit është t'u ofrojë ndihmë juridike kategorive të caktuara të individëve, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të aksesuar në procesin gjyqësor. Nëpërmjet interpretimit të dispozitave të mësipërme të KPC-së si dhe analogjisë me ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, arrihet qartësisht në përfundimin se qëllimi i këtij kuadri ligjor është të garantojë aksesin në gjykatë për të gjithë individët që i drejtohen gjykatës. Neni 13 i këtij ligji, për personat që përfitojnë ndihmë ligjore falas përcakton se:

“1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët:

³a) Vërejtje me shkrim; b) Vërejtje me paralajmërim; c) Gjobë, nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë; ç) Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore publike dhe private. d) Pezullim nga drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Mjekëve deri në 3 (tre) vjet; dh) Përrjashtim i përkohshëm nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 (tre) vjet. 2. Masa ndëshkuese e parashikuar në shkronjën “dh” sjell si rrjedhojë ç’regjistrim nga Regjistri i Mjekëve të Rajonit dhe ai Kombëtar, si dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit për afatin e caktuar në Vendimin Disiplinor.

b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetohet se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to.

3. Ndihma juridike mund të kërkohet para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor.

4. Personi, i cili përfiton ndihmë juridike, ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin, që siguron ndihmën juridike, të japë informacion të vërtetë, për të cilin është kërkuar ndihma juridike, si dhe të sigurojë në kohë çdo informacion për rrethanat dhe kushtet, që kanë ndryshuar shkakun e dhënies së ndihmës.

5. Mospbatimi i pikës 4 të këtij neni nga personi, që përfiton ndihmën juridike për çështjet civile ose administrative, përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të përfitimit të kësaj ndihme juridike”.

Përsa më sipër, lidhur me problematikën tuaj, Komisioneri ju sugjeron t'i drejtoheni Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike⁴, ose Shërbimit Ligjor Falas⁵, e cila është një shoqatë jofitimprurëse që në fokus të punës së vet ka mbrojtjen e të drejtave dhe ndihmën ligjore të personave në nevojë. Kjo shoqatë ofron shërbim ligjor falas për çështje të së drejtës familjare, civile, administrative dhe të punës.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Neni 33 pikat 3/c/ç, 4/b/ç e ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” citon shprehimisht se: “*ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji*”. Për

⁴Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

⁵Me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, 4 kullat, seksioni III, Ap. 1A, Kutia Postare nr.69, Tiranë
Nr.tel.: 0422 53114

këtë arsye,çështja e parashtruar nuk mund të shqyrtohet më tej, sepse nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 7, pika 1, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), si dhe nënenin 33, pika 4, gërma ç), të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimine ankesës së z.M. R, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Komisioneri i rekomandon z.M. R t’i drejtohet me shkrim, me anë të një ankese, Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, për rastin e djalit të tij.
3. Komisioneri i rekomandon subjektit ankues t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike⁶, ose Shërbimit Ligjor Falas⁷.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU
KOMISIONERI

Fusha: Shërbime

Shkaku: Raca, gjendja ekonomike

⁶Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. ‘Zogu i Parë’, Tiranë.

⁷Me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, 4 kullat, seksioni III, Ap. 1A, Kutia Postare nr.69, Tiranë
Nr.tel.: 0422 53114